



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës

Nr. 04-111/01-27293/18

Datë, 17.08.2018

Në bazë të Ligjit nr. 04/L- 032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 22/2013 për numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës shpallë:

KONKURS

Për Regjistrimin e Nxënësve në Klasën e Dhjetë (10) në Gjimnaz dhe Shkollën Profesionale për vitin shkollor 2018/2019

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt
Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe të shkollave profesionale, për vitin shkollor 2018/19, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç. Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9- të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.
2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim
Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaz dhe shkollën profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:
Fletëparaqitja (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
Dëftesa origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
Ekstrakti i lindjes.

Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaz dhe shkollë profesionale për vitin shkollor 2018/2019, bëhet më datën **20, 22 dhe 23 gusht 2018** në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora **8.00-16.00**.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën **24.08.2018**. Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej **27.08.2018**. Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHT - Komisionit për ankesa.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

1. Suksesi nga shkollimi i obliguar (25%) 25 pikë
2. Suksesi nga lëndët prioritare në test (15%) 15 pikë
3. Numri i pikëve nga testi (60%) 60 pikë

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë 100 pikë.

SHMP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka"- KAÇANIK

Nr.	DREJTIMI	PROFILI	Nr. i paraleleve	Nr.i nxën të planif	Nr i nx të regi/Qershor	Vende të lira/ Gusht
1.	ELEKTROT EKNIKË	- Teknik i telekomunikacionit	1	32	1	31
		- Teknik i informatikës	1	32	7	25
		- Instalues elektrik	1	24	8	16
2.	EKONOMI	- Banka dhe sigurime	1	32	3	29
		- Asistent i marketingut	1	32	7	25
3.	KOMUNIKACION	- Transport rrugor	1	32	7	25
4.	MAKINERI	- Instalues i ngrohjes qendrore	1	24	10	14
		- Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit	1	24	2	22
		- Saldator	1	24	0	24
		- Automekanik	1	24	6	18

		-Mekatronik	1	32	1	31
5.	JURIDIK	- Asistent juridik	1	32	4	28
Gj			12	344	56	288

Gjimnazi “ Skënderbeu” - KAÇANIK

Nr.	DREJTIMI	Nr. i paraleleve	Nr.i nxënës të planifikuar	Nr i nx të regj/Qershor	Vende të lira/Gusht
1.	Shkenca Natyrore	4	128	105	23
2.	Shkenca Shoqërore-Gjuhësore	5	160	111	49
Gjit hsej		9	288	216	72

Drejtori i DAK
z. Zahir Doda

